

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7900  
E hënë, 7 tetor 2024  
Çmimi 0.50

Ekipet ndërkombëtare të shpëtimit ndihmojnë Bosnjën pas përmbytjeve vdekjeprurëse | **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI

## GJENDJA POLITIKE ËSHTË MË E DËMTUAR SE AJO E SIGURISË | **FAQE 4-5**

**-Qeveria e ardhshme është më e shëndetshme nëse është qeveri koalicioni i partive aktualisht opozitare**



Ish-kryeinspektori i AKI-së dhe eksperti i çështjeve të sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se gjendja politike në vend është më e dëmtuar se ajo e sigurisë. Ramadani në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se sot shohim bllokadë në diplomaci, ngecje në ekonomi, korrupsion

dhe krim. Sa i përket situatës në veri, Ramadani ka vlerësuar se veprimet atje kanë qenë të nevojshme, por sipas tij çmimi duket të jetë i lartë. Ramadani ka theksuar se rrahgjoksja e pushtetit para popullit të Kosovës nuk është në përputhje me situatën në veri. Në këtë

kontekst, Ramadani, ka theksuar se veriu është shpjeguar nga pushteti si emocion, duke mos arritur të ndërtojë argumentim diplomatik racional. Ai ka thënë se sulmi në Banjskë nuk është trajtuar profesionalisht as nga Kosova dhe as nga faktori ndërkombëtar

### AKTUALE



**SALI BISLIMI: SHOIPTARË MOS LEJONI TË FITON TRADHTIA, KEMI KATËR BURRA NË HAGË QË I DHANË LIRINË DHE PAQEN DARDANISË | **F. 6****

**UKRAINA DO TË SHKËMBEJË TERRITORE? "FINANCIAL TIMES" ZBARDH PLANIN QË PO DISKUTON PERËNDIMI PËR TA FUTUR NË NATO | **F. 2****

### EKONOMI



**RËNIE E DUKSHME E KONSUMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NË VERI TË KOSOVËS PAS FILLIMIT TË FATURIMIT | **F. 7****

**MIRATOHET UDHËZIMI PËR STANDARDIZIMIN E QR KODIT QË DO TË PËRDORET PËR PAGESAT NË KOSOVË | **F. 7****

### SPORT



**DERI I TAKON PRISHTINËS, BASHKIMI REGJISTRON FITOREN E KATËRT RADHAZI | **F. 10****

**QEVERIA E KOSOVËS NAVIGON MES NACIONALIZMIT DHE PRITJEVE TË SHBA-së | **F. 3****



**TRE TË VDEKUR GJATË NJË AKSIDENTI NË LIQENIN E BADO CIT | **F. 7****



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
**STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË**

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Ukraina do të shkëmbejë territore? “Financial Times” zbardh planin që po diskuton perëndimi për ta futur në NATO

KIEV, 6 TETOR - Lufta në Ukrainë arriti në ditën e 956 dhe zyrtarët e Kievit, së bashku edhe me aleatët perëndimorë, me sa duket po vlerësojnë një kompromis të mundshëm që përfshin “anëtarësimin e Ukrainës në NATO në këmbim të disa territoreve të pushtuara nga Rusia”. Lajmin e ka bërë me dije “Financial Times”.

Deri tani gjithçka është në kuadrin e diskutimeve, por situata është komplikuar së fundmi sepse nuk ka konsensus në Këshillin e Bashkimit Evropian për një zgjatje kohore të sanksioneve, apo një bllokim tjetër ndaj aseteve që Banka Qendrore Ruse zotëron në

Evropë.

Kjo marrëveshje konsiderohet thelbësore për t'i dhënë garanci ShBA-ve që të marrin pjesë me 20 miliardë dollarë në huan që G7 ka vendosur të marrë për të ndihmuar Ukrainën. Ndër vendet më të zëshme që kundërshtojnë huan është Hungaria.

Gjatë vizitës së tij në Kiev, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte bëri me dije se ishte pro hyrjes së Ukrainës në Aleancën e Atlantikut, por Volodymyr Zelensky iu përgjigj se NATO duhet të dërgojë sa më shpejt armët me reze të gjatë veprimi: “Pa mjete të caktuara dhe mundësinë e përdorimit të

këtyre armëve, ne nuk mund ta ndalojmë Rusinë”, deklaroi Zelensky.

Ekspertët thonë se në kushtet aktuale është e vështirë që Ukraina t'i bëjë ballë luftës, ndaj edhe është rikthehet ideja e këmbimit të territoreve. Ata vënë në dukje se konflikti Rusi-Ukrainë ka nisur që para 10 vitesh, me agresionin e Moskës në rajonin e Donbasit. Që prej vitit 2014 Rusia në forma të ndryshme i ka marrë vazhdimisht territore Ukrainës, ndërsa kjo e fundit ka surprizuar vetëm me një betejë: atë në rajonin e Kurskut, por është shumë pak në raport me çfarë ka humbur në një dekadë.



## Ekipet ndërkombëtare të shpëtimit ndihmojnë Bosnjën pas përmbytjeve vdekjeprurëse



SARAJEVË, 6 TETOR - Ekipet e shpëtimit nga shtetet fqinje të Bosnjës e Hercegovinës dhe nga Bashkimi Evropian të dielën u janë bashkuar përpjekjeve për të gjetur njerëzit e zhdukur nga vërshimet dhe rrëshqitjet e dheut dhe për pastruat rrënojat. Bosnja ka kërkuar ndihmë nga BE-ja pasi reshjet e mëdha të shiut të enjten dhe të premten shkaktuan vërshime dhe rrëshqitje të dheut, që kanë lënë të vdekur të paktën 18 persona. Fatkeqësia natyrore po ashtu ka shkatërruar rrugë dhe ura dhe ka lënë të plagosur dhjetëra persona. Zyrtarët thanë se të paktën 10 persona ende konsiderohen të zhdukur, shumica nga fshati

Donja Jabllanica, në jug të Bosnjës, fshat ku ka pasur rrëshqitje të mëdha të dheut.

Luigi Soreca, kreu i misionit të BE-së në Bosnje, shkroi në X, se blloku evropian qëndron me Bosnjën dhe se ekipet e shpëtimit po shkojnë për të ndihmuar këtë shtet.

Autoritetet thanë se ekipet e shpëtimit nga Kroacia kanë shkuar, ndërkaq një ekip nga Serbia pritet të shkojë në Bosnje më vonë gjatë 6 tetorit, pasur nga një ekip për shpëtim i përbërë nga qentë që do të dërgohet nga Sllovenia. Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Republika Çeke dhe Turqia po ashtu kanë ofruar ndihmë, thanë autoritetet në Bosnje.

## Djathtistët evropianë mbështesin Salvinin para vendimit gjyqësor për emigrantët

BRUKSEL, 6 TETOR - Udhëheqësit evropianë të ekstremit të djathtë shprehën mbështetjen e tyre për zëvendëskryeministrin e Italisë, Matteo Salvini, i cili përballet me mundësinë e dënimit deri me gjashtë vjet burgim, pasi kishte refuzuar që të lejonte ankorimin e një anijeje me migrantë më 2019, në kohën kur ishte ministër i Brendshëm.

Kryeministri hungarez, Viktor Orban, dhe nacionalisti holandez, Greet Wilders, iu bashkuan politikanëve të tjerë nga e mbarë Evropa për t'u adresuar në tubimin vjetor të Partisë Liga të Salvinin, që u mbajt në Pontida në veri të Italisë. “Ju jeni heroi ynë. Ne jemi me ju, prandaj kemi ardhur

këtu”, tha Wilders, partia e të cilit, që është kundër islamit, për herë të parë gjatë këtij viti u bë pjesë e Qeverisë në Holandë, teksa ekstremi i djathtë ka shënuar rritje në kontinentin evropian.

Parti të ekstremit të djathtë në Evropë në qershor u bashkuan duke krijuar grupin e Patriotëve për Evropën - grupimi i tretë më i madh në Parlamentin Evropian dhe këto parti synojnë të zvogëlojnë fuqinë e Brukselit dhe të ndalin imigrimin ilegal.

Muajin e kaluar, prokurorët kërkuar që Salvini të dënohet me gjashtë vjet burgim për shkak të vendimit të tij më 2019 për të pamundësuar zbakimin e më shumë se 100 emigrantëve në Itali.



Prokurorët thanë se ai efektivisht kishte rrëmbyer emigrantët, duke i detyruar që të qëndronin në det për pothuajse një javë, pavarësisht se kushtet në anijen e tyre ishin të

këqija. “Ai meriton të përgëzohet e jo të ndëshkohet”, tha Orban gjatë tubimit para mbështetësve të Salvinin. “Ai mbrojti shtëpitë e italianëve, ai po ashtu mbrojti

Evropën”.

Seanca e radhës gjyqësore ndaj Salvinin është caktuar më 18 tetor, por ende është e paqartë se kur do të merret vendimi për rastin. “Ata mund të arrestojnë një person që mbrojti kufijtë kombëtarë, por jo të gjithë njerëzit. Ata nuk mund ta ndalin aleancën e shenjtë të popujve evropianë që lindi sot në Pontida”, tha Salvini.

Orban tha se ndjenja antimigrante është përhapur në mbarë Evropën dhe kërcënoi se do t'i dërgojë azilkërkuarit në Bruksel nëse Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk shfuqizon vendimin për gjobë prej 1 milion eurosh në ditë për Hungarinë për shkak të shkeljeve të ligjeve për azil.

# Qeveria e Kosovës navigon mes nacionalizmit dhe pritjeve të ShBA-së

PRISHTINË, 6 TETOR - Nën udhëheqjen e kryeministrit Albin Kurti, Kosova ka bërë hapa që disa ekspertë thonë se i sfidojnë normat tradicionale diplomatike.

Me fjalët e Daniel Serwerit, profesor në Universitetin Johns Hopkins, "amerikanët nuk janë mësuar me një kryeministër të Kosovës që sillet si kryeministër i një shteti sovran". "Ata mendojnë se ai duhet të konsultohet për gjithçka. Madje, janë mësuar që kryeministrat e Kosovës të ndjekin shumë udhëzime nga Uashingtoni. Dhe, ta them të vërtetën, sjellja e Kurtit nuk pranohet mirë prej tyre", thotë Serwer për programin Expose të Radios Evropa e Lirë.

Charles Kupchan, profesor në Universitetin Georgetown, thotë se Kurti po i vendos interesat e brendshme politike përpara interesave kombëtare. "Ngritja kundër Uashingtonit, shfaqja e muskujve dhe tregimi i njëfarë autonomie duket se e ndihmojnë Kurtin për të fituar popullaritet. Unë e shoh këtë si një lojë dritëshkurtër. Mund të jetë politikisht e dobishme në afat të shkurtër, por është e rrezikshme në afat të gjatë", thotë Kupchan.

Kurti, sidomos në dy vjetët e fundit të qeverisjes, e ka pasur shtrirjen e kontrollit në zonat me shumicë serbe në veri të Kosovës pjesë të rëndësishme të politikës së tij.

Mes tjerash, ka zëvendësuar targat serbe me targa të Kosovës, ka instaluar kryetarët shqiptarë në komunat me shumicë serbe dhe ka hequr nga përdorimi dinarin serb.

Për ShBA-në - e cila kërkon që të gjitha çështjet që lidhen me situatën në veri, të trajtohen në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë - të gjithë këta hapa kanë qenë të njëanshëm dhe të pakoordinuar dhe kanë ndikuar, sipas saj, në partneritetin mes dy vendeve.

Veprimi i fundit i Kurtit që ka zemëruar Uashingtonin, ka qenë mbyllja e disa institucioneve paralele serbe në veri - më 30 gusht - prej nga komuniteti lokal prej vitesh ka marrë shërbime të ndryshme.

Ambasada amerikane në Prishtinë ka lëshuar atëkohë një nga kritikën më të ashpra për Qeverinë e Kosovës. "Shtetet e Bashkuara dhe partnerët tanë ndërkombëtarë kanë kërkuar vazhdimisht nga Qeveria e Kosovës që ta ketë prioritet koordinimin me bashkësinë ndërkombëtare dhe të mos ndërmarrë veprime të njëanshme për çështjet që janë në agjendën e dialogut të

lehtësuar nga BE-ja. Dështimi i Qeverisë së Kosovës për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave, paraqet një përkeqësim real dhe në rritje të partneritetit tonë", është thënë në reagim.

Javën e kaluar, ka pasur raporte se Shtetet e Bashkuara kanë pezulluar bashkëpunimin me Policinë e Kosovës, konkretisht në fushën e trajnimeve, si masë ndëshkuese.

E kontaktuar nga Radio Evropa e Lirë, Ambasada amerikane ka konfirmuar se është duke e shqyrtuar vazhdimin e trajnimeve të Policisë së Kosovës, porse, aktualisht, nuk ka ndonjë vendim.

Ato ditë, Kurti ka qenë për një vizitë në ShBA, ku, mes të tjerëve, ka takuar ndihmësin e sekretarit amerikan të Shtetit, James O'Brien, dhe të dërguarin amerikan për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kananof, por nuk ka bërë të ditur se për çfarë është biseduar.

Kurti vazhdimisht këmbëngul se veprimet e Qeverisë së tij nuk janë të drejtuara kundër askujt, se ndjek Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe se marrëdhëniet me ShBA-në janë të mira, përkundër mospajtimeve për disa çështje. Kupchan nuk pajtohet plotësisht. Ai thotë se marrëdhëniet e ShBA-së me Qeverinë e Kosovës janë në nivelin më të ulët ndonjëherë.

"Uashingtoni dhe partnerët e Uashingtonit në Evropë nuk ndihen rehat me kthesën më konfrontuese që ka marrë kryeministri Kurti kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ka qenë një periudhë e gjatë, kur Serbia është parë si problem, kur Serbia e ka penguar përmirësimin e marrëdhënieve ekonomike dhe politike. Por, Kurti e ka ndryshuar këtë. Tani kemi më shumë kritika të drejtuara ndaj Prishtinës sesa ndaj Beogradit", thotë Kupchan për Exposenë.

Për të, kjo ka një shpjegim: Në Kosovë, më 9 shkurt, do të mbahen zgjedhjet parlamentare dhe Kurti luan me kartën nacionaliste. "Duke parë pothuajse në çdo vend tjetër të botës se nacionalizmi funksionon mirë, Kurti mbyll institucione paralele serbe, instalon kryetarë shqiptarë në komunat me shumicë serbe, ndryshon rregullat e kartave të identitetit apo të targave të makinave...". "Si shtet sovran, Kosova ka plotësisht të drejtë t'i bëjë këto gjëra, por mua nuk më duken hapa të zgjuar, nëse merret parasysh qëllimi final, që është normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë dhe



hapa e rrugës për integrimin e plotë të Kosovës në institucionet atlantike", thotë Kupchan.

Kurti nuk është takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për më shumë se një vit. Ai është shprehur skeptik edhe për thirrjet që u ka bërë Vuçiq serbëve të veriut që të riintegrohen në institucionet e Kosovës, pas largimit masiv në vitin 2022, për shkak të vendimit për targat.

Serwer beson se ShBA-ja nuk do ta tërheqë kurrë mbështetjen e saj për Kosovën si shtet i pavarur, por pranon se ndihma amerikane mund të ndryshojë. Ai thekson nevojën për më shumë diplomaci në adresimin e çështjeve që, siç thotë, mund të mos i përmbushin pritjet e ShBA-së. "Mendoj se është koha që t'iu jepet prioritet marrëdhënieve me amerikanët, të shihet se çfarë mund të bëhet për të siguruar më shumë mbështetje prej tyre për

sovrانيتetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Unë nuk do të bëja fare kompromis për këtë, por do t'i thosha Uashingtonit: epo mirë, çfarë të duhet? Na trego çfarë të duhet dhe ne do të shohim se çfarë mund të bëjmë", thotë Serwer. Shtetet e Bashkuara kanë ndarë për Kosovën mbi dy miliardë dollarë që nga viti 1998. Mbështetja e tyre ka qenë vendimtare për fushatën e bombardimeve të NATO-s në ish-Jugosllavi - e cila i ka dhënë fund luftës në Kosovë - e pastaj edhe në rrugën e Kosovës drejt pavarësisë.

Uashingtoni ka qenë ndër të parët që e ka njohur shtetësinë e Kosovës në vitin 2008. Ai i ka trupat e veta ushtarake në Kosovë, të angazhuara në misionin e NATO-s, KFOR, dhe udhëheqësit e Kosovës përsërisin shpesh se ShBA-ja është partnerja më e rëndësishme e Kosovës.

Radio Evropa e Lirë ka pyetur

Departamentin amerikan të Shtetit se si i vlerëson marrëdhëniet aktuale me Qeverinë e Kosovës dhe, në përgjigje, prej tij kanë kërkuar që të merret për bazë një deklaratë e zëdhënësit Matthew Miller nga muaji gusht, i cili ka thënë se Kosova "po i vë në rrezik mundësitë që Uashingtoni e ka ndihmuar t'i krijojë".


Sipas analistëve, gjëja e fundit që i duhet Kosovës tani, është të gjendet e izoluar politikisht, sepse "është një vend i vogël, që jeton në një rajon të rrezikshëm". "Çdo vend i vogël ka nevojë për aleanca për të mbijetuar dhe lulëzuar. Nuk ka dyshim për këtë. Si mbijeton Luksemburgu? Si mbijeton Belgjika? Si mbijeton Holanda? Ato mbijetojnë, sepse janë në një sistem miqsh dhe aleatësh, që u mundëson të mbijetojnë dhe të lulëzojnë", thotë Serwer.

Për Kupchanin, sukcesi afatgjatë i Kosovës si shtet, qëndron tek aftësia e saj për t'i naviguar me kujdes marrëdhëniet e jashtme, sidomos me aleatë të fuqishëm si ShBA-ja. Hapat e njëanshëm janë problem, sipas tij. "Mund të ndodhë që pas zgjedhjeve, Kurti - duke supozuar se do të rizgjidhet - të ketë një qasje tjetër, sepse zgjedhjet do të jenë pas tij dhe për të do të bëhet më e lehtë që të përqafojë një pozicion më bashkëpunues dhe më pak konfrontues", thotë Kupchan. Pavarësisht marrëdhënieve ShBA-Qeveri e Kosovës dhe tatëpjetave mes tyre, një gjë është e sigurt: ato nuk mund ta zbehin entuziazmin e kosovarëve për udhëheqjen e shtetit më të fuqishëm në botë.

Një sondazh që ka publikuar kompania amerikane e analizave, Gallup, në muajin prill, ka gjetur se Kosova ka vlerësimin më të lartë për lidhshimin amerikan në mesin e 134 vendeve dhe territoreve të anketuara.

Kjo, edhe përkundër disa ndëshkimeve. Në maj të vitit të kaluar, Kosova është përjashtuar nga stërvitjet ushtarake "Defender Europe '23", sepse Qeveria e saj nuk e ka dëgjuar këshillën e ShBA-së për hapa drejt uljes së tensioneve në veri të vendit.

Njësoj në ujëra të turbullt, për arsye të ngjashme, Kosova është edhe me BE-në, e cila ka në fuqi disa masa ndëshkuese. Nëse Qeveria do ta gjejë rrugën për t'u ribërë partnere e besueshme, apo do të vazhdojë të dirigjohet nga ambiciet e veta, mbetet për t'u parë, përfundojnë analistët.



FLET PËR "EPOKËN E RE", BURIM RAMADANI

# Gjendja politike është më e dëmtuar se ajo e sigurisë

**-Qeveria e ardhshme është më e shëndetshme nëse është qeveri koalicioni i partive aktualisht opozitare**

Ish-kryeinspektori i AKI-së dhe eksperti i çështjeve të sigurisë, Burim Ramadani, ka vlerësuar se gjendja politike në vend është më e dëmtuar se ajo e sigurisë. Ramadani në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se sot shohim bllokadë në diplomaci, ngecje në ekonomi, korrupsion dhe krim. Sa i përket situatës në veri, Ramadani ka vlerësuar se veprimet atje kanë qenë të nevojshme, por sipas tij çmimi duket të jetë i lartë. Ramadani ka theksuar se rrahagjoksja e pushtetit para popullit të Kosovës nuk është në përputhje me situatën në veri. Në këtë kontekst, Ramadani, ka theksuar se veriu është shpjeguar nga pushteti si emocion, duke mos arritur të ndërtojë argumentim diplomatik racional. Ai ka thënë se sulmi në Banjskë nuk është trajtuar profesionalisht as nga Kosova dhe as nga faktori ndërkombëtar

dhe të jashtme të Kosovës, e cila domosdoshmërisht ndërlidhet pastaj me situatën e sigurisë. Është e qartë se në aspektin e sigurisë, Kosova po ballafaqohet në vazhdimësi me luftën hibride që Serbia dhe mentori i saj, Rusia, kanë bërë dhe po bëjnë kundër Kosovës. Kjo, mbi të gjitha, synon që të mbajë Kosovën nën tension të vazhdueshëm, të pamundësuar konsolidimin e integritetit të shoqërisë kosovare në tërësi në modelin e shtetit të Kosovës, të thellojë përçarjen midis shqiptarëve shumicë dhe serbëve pakicë në Kosovë, të mbajë temën e konfliktit dhe konflikteve në vazhdimësi në top-temën publike, të koncentrojë përpjekjet e institucioneve të Kosovës vetëm në një fushë (pra atë të sigurisë), sikurse edhe frikësorë çfarëdo iniciative të investimeve të huaja direkte në Kosovë. Në përgjithësi, kjo Luftë Hibride, në të cilën shpesh po biem edhe ne si shoqëri, e ka për qëllim vendosjen e Kosovës në një situatë pezull, në të cilën

zhvillim ekonomik nuk ka, prosperitet për qendrueshmëri qytetarët nuk shohin, si dhe perceptimi global për Kosovën mbetet tek "Kosova është zonë krize!".

Në anën tjetër, prezenca e shtuar e NATO-s në Kosovë e qartëson pastër se një konflikt klasik konvencional i Serbisë kundër Kosovës nuk mund të ndodh. Në rrethana të këtylla, Ushtria serbe vetëm ëndërron pushtimin e Kosovës.

**"Epoka e re": Si i keni parë veprimet e qeverisë Kurti për vendosjen e rendit në veri të vendit?**

**Ramadani:** Integrimi i veriut nuk u përmyll ende. Prezenca më e madhe dhe më e dukshme e institucioneve të zbatimit të ligjit në atë pjesë të Kosovës edhe ka qenë e domosdoshme, edhe duhet të shihet si instrument për qëllimin e integritetit. Pra, situata e këtyllë e tashme në veri nuk është dhe nuk duhet të jetë qëllimi final, por duhet t'i shërbejë qëllimit final të Kosovës për të integruar

popullatën lokale të atjeshme në sistemin politik-institucional e shoqëror të Kosovës.

Veprimet e deritashme, në përgjithësi, kanë qenë të nevojshme në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve paraprake që Kosova ka arritur në Bruksel me Serbinë, në kuadër të dialogut. E vërteta është që për këto veprime çmimi tash për tash duket të jetë i lartë. E mbi të gjitha për shkak se integrimi i veriut në shoqërinë kosovare nuk është përmyllur.

Në këtë kontekst, është fakt se janë tri palë që ndikojnë në situatën e përgjithshme në veri. Së pari, Qeveria e Kosovës, e cila domosdoshmërisht ka për qëllim sundimin e ligjit. Së dyti, partnerët ndërkombëtar, të cilët kanë mandat për të mirëmbajtur dhe mbrojtur sigurinë. Dhe, së treti, Qeveria e Serbisë e cila gjatë krejt këtyre dekadave ka abuzuar me ndjenjat e serbëve lokal në veri të Kosovës, duke penguar çfarëdolloj procesi për integrim të mirëfilltë të tyre në sistemin

zbehur dukshëm optimizmin e qytetarëve të Kosovës, kryesisht për shkak të dështimeve në realizimin e pritjeve që kanë pasur qytetarët për këtë periudhë.

Sot shohim bllokadë në diplomaci, ngecje në ekonomi, korrupsionin e krimin në vazhdimësi. Kjo besoj se është fjali që mund ta përshkruaj gjendjen politike të brendshme

kosovar. Prandaj, argumentimi i qartë dhe profesional i kësaj situatë do të mund të merrte mbështetjen e plotë të partnerëve ndërkombëtarë për veprimet e Qeverisë së Kosovës dhe kështu secili veprim do të paraqiste sukses në vete. Por, fatkeqësisht, ne nuk kemi parë përkushtim e profesionalitet të Qeverisë sonë për të ndërtuar argumentimin diplomatik. Prandaj, edhe çmimi është shumë më i lartë.

Ekspozitët e pushtetit në vazhdimësi janë duke u krenuar për gjendjen në veri, ndërsa faktori ndërkombëtar ka kritikuar veprimet e qeverisë. A besoni se me këtë qasje dhe pa mbështetje sidomos të aleatëve mund të vijë në shprehje integrimi i plotë i veriut në jetën politike dhe institucionale?

Siguria kombëtare, ku përfshihet edhe integrimi i tërë shoqërisë së shtetit në sistemin tonë, nuk është dhe nuk është dashur asnjëherë të trajtohet për nga aspekti emocional. Ky besoj që ka qenë gabimi fillestar i kësaj strukture pushteti. Pra, veriun e kanë shpjeguar si emocion, por nuk kanë arritur të ndërtojnë argumentim diplomatik racional.

Rrahagjoksja para popullit të Kosovës nuk është në përputhje me situatën në veri. As me raportin tonë Kushtetues me faktorin ndërkombëtar në Kosovë. Saherë që ekspertët të pushtetit kanë kthyer temën e veriut në çështje elektorale e populiste, NATO ka treguar fuqinë e vet brenda Kosovës. Mesazhet e tilla duhet të trajtohen dhe lexohen pa emocion. Sepse, gabimi më i madh në siguri kombëtare është sjellja emocionale.

Ja një shembull ilustrues të nevojës së leximit të mesazheve: kur më 26 korrik 2024 është organizuar Gara e Kërcimit në Liqenin e Ujmanit, në të njëjtën kohë atë ditë KFOR-i ka publikuar një video të patrullimit të përbashkët të KFOR-it me Ushtrinë e Serbisë. Këto janë momente kur emocionet mund të jenë në projekte kulturore a sportive, por siguria kombëtare kërkon planifikim afat-gjatë dhe profesional.

**"Epoka e re":** A ka arritur ta shfrytëzojë qeveria aq sa duhet sulmin terrorist në Banjskë?

**Ramadani:** Sulmi paramilitar terrorist në Banjskë ka nxitur reagimin e shpejtë të NATO-s, duke rritur për rreth 1000 trupa më shumë në Kosovë. Në të njëjtën kohë, ka dëshmuar një mangësi të dukshme profesionale diplomatike të Kosovës.

Unë nuk arrij të kuptoj pse (as pas sulmit në Banjskë), institucionet e Kosovës nuk kanë shumëfishuar prezencën diplomatike dhe profesionale në Bruksel dhe në kryeqendrat e shteteve anëtare të NATO-s?

Apo, si nuk kanë ndërtuar një platformë të qartë nacionale, profesionalisht të argumentuar, për të filluar aktivitetin intensiv informues nëpër botë?

Mendoj që sulmi paramilitar terrorist i Serbisë në Banjskë nuk është trajtuar profesionalisht as nga Kosova, as nga faktori ndërkombëtar. Kosova është dashur të ketë rol aktiv në këtë. Më duket se ka pasur një ndjenjë të vetëmjaftueshmërisë së njerëzve që janë aktualisht në institucione dhe kështu nuk kanë pasur projekt për të ndërtuar ekipe të gjera nacionale. Kjo edhe i ka zvogëluar mundësitë që Kosova ta dëshmojë rastin e vet.

**"Epoka e re":** Vazhdimisht keni qenë kritik sa i përket trajtimit të sferës së sigurisë nga ana e institucioneve të vendit. Pse?

**Ramadani:** Kam qenë edhe mbështetës për institucionet e Kosovës në angazhimet për t'u përballur me propagandën serbe e ruse kundër Kosovës. Përmes aktiviteteve krejtësisht vullnetare, pas asnjë lloj mbështetje, kam pasur një cikël të video-materialeve pikërisht në përballje të propagandës armiqësore.

Kjo edhe ka qenë vullnetare dhe dashamirëse në rolin e qytetarit të lirë, edhe ka arritur efekte në përgjithësi në opinion jo vetëm brenda Kosovës.

Unë kam qenë dhe mbetem kritik për mungesën e një qasje gjithëpërfshirëse, profesionale e të strukturuar të institucioneve të Kosovës në fushën e sigurisë kombëtare. Aq më shumë, kam qenë dhe mbetem kritik për një dëshirë të flaktë të ekspertëve të ndryshëm të pushtetit që çështjet e sigurisë kombëtare t'i trajtojnë dhe abuzojnë për synime elektorale dhe linçuese. Sepse, ky është gabim i padilemë.

**"Epoka e re":** Sipas jush në çfarë forme është duke u trajtuar policia dhe ushtria nga ana e qeverisë Kurti?

**Ramadani:** Besoj se Policia dhe Ushtria në Kosovë – këto institucione me profesionalitet të lartë e të lakmueshëm nga shtetet në rajon – po trajtohen pa dinjitet. Në kohën kur ngecja ekonomike ka marrë përmasa shqetësuese, inflacioni ka reduktuar dukshëm fuqinë blerëse të qytetarëve dhe familjeve, policia dhe ushtria janë të parat që duhet të kenë përmirësim të kushteve, rritje të pagave, sigurimin shëndetësor dhe pakon sociale.

Fakti që numri i pjesëtarëve të FSK-së që lëshojnë ushtrinë është enorm tregon për një situatë për të cilin duhet të shqetësohen udhëheqësit e institucioneve. Buxhet ka, pra para ka, por nuk ka vendosmëri për kushte më të mira të ushtarëve dhe policëve.

Sa shpenzojnë para për të mbjell pisha në Kazerma, që pas pak ditësh janë tharë, më



mirë ato mjete të ndaheshin për ushtarët!

**"Epoka e re":** Z. Ramadani si e keni parë rolin e opozitës sa i përket kritikave dhe ofrimit të alternativave në raport me zhvillimet e përgjithshme në Kosovë?

**Ramadani:** Jemi dëshmitar që opozita ka dëshmuar një gjë: nuk ka qenë faktor destabiliteti gjatë këtyre katër vjetësh. Pra, Qeveria në Kosovë, si asnjëherë më parë, ka pasur qetësinë dhe hapësirën e plotë për të vepruar, për të zbatuar politikën, për të përmbushur premtimet që u ka dhënë qytetarëve.

Unë besoj se ky është një tregues i mirë për opozitën. Por, mbetet vetëm tregues.

Në bindjen time, qeveria e ardhshme do të jetë qeveri koalicioni. Duke qenë kështu, atëherë besoj se qeveria e ardhshme është më e shëndetshme nëse është qeveri koalicioni i partive aktualisht opozitare.

Nëse kjo arrihet, besoj se mund të hyjmë në një cikël të zhvillimit normal demokratik, ku pushtetet ndërrohen pa zhurma, protesta e situata ku policët lëndohen. Në këtë kuptim, shpresoj se përvoja dhe vendosmëria do të kombinohet me qasjen teknokratike për të ndërtuar qeverinë e ardhshme. Nëse ndërrohet pushteti përmes bashkimit të ndonjërit nga partitë opozitare me qeverinë e tashme, mendoj se ndryshimi do të jetë i pjesshëm.

**"Epoka e re":** A do të ju shohim përsëri në politikë?

**Ramadani:** Jo, nuk kam planifikim të shpejtë për rikthim në politikë. Nuk jam në garë. Jam jashtë anëtarësisë dhe politikave partiake që prej periudhës kur jam emëruar në detyrën e fundit publike, Inspektor i përgjithshëm i AKI-së në nëntor të vitit 2019, dhe si i tillë do të nderoj detyrën prej të cilës kam dalë në dhjetor 2022.

Shpresoj se kontributi im i tashëm publik të jetë momentalisht i mjaftueshëm, kryesisht në rekomandime e këshilla edhe publike në fushën e sigurisë kombëtare, si një lloj këshillimi dhe edukimi publik për shoqërinë dhe institucionet kosovare.

## I varroset i vëllai, procesi i Hagës ia pamundëson prezencën Jakup Krasniqit

PRISHTINË, 6 TETOR - Të dielën në fshatin Negroc të Drenasit i është dhënë lamtumira e fundit, Azem Krasniqit, vëllait të ish-kryeparlamentarit të Kosovës, Jakup Krasniqit. Në ceremoninë e varrimit morën pjesë qindra qytetarë nga anë e mbanë vendi, megjithatë aty nuk u pa, Jakup Krasniqi për shkak të procesit gjyqësor nga Dhomat e Specializuara.

Vëllai i Jakup Krasniqit, Azemi, u nda nga jeta mbrëmjen e së shtunës. Ai kishte pësuar sulm në tru dhe për disa muaj ka qenë në komë. "Për familjen dhe të gjithë ata që e kanë njohur, Azemi ka qenë njeri i urtë, familjar, mik e shok shembullor, i cili pas vetes ka lënë vetëm vepra e kujtime të mira. Më e rënda në këtë rast ishte dhimbja e të gjithë neve

që ishim në varrim dhe dashamirëve të familjes se nuk ishte i pranishëm, në varrimin e vëllait më të ri, Baci Jakup", ka thënë kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci. Ai ka thënë se as familja e madhe Krasniqi, as Baci Jakup nuk janë vetëm. "Ngushëllime familje e nderuar Krasniqi, i paharrueshëm qoftë kujtimi!", ka pohuar kryetari Lladrovci.



## Sali Bislimi: Shqiptarë mos lejoni të fiton tradhtia, kemi katër burra në Hagë që i dhanë lirinë dhe paqen Dardanisë



PRISHTINË, 6 TETOR - Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, edhe një herë ka dalë në mbrojtje të vlerave të luftës së UÇK-së. Ai ka thënë se shqiptarët duhet të jenë të bashkuar kur janë në pyetje vlerat kombëtare e çlirimtare. "Shqiptarë mos lejoni të fiton tradhtia. Pak histori. Pasi na vranë na thanë nëse ju doni të ekzistoni duhet që Krishtin me muhamedin ta zëvendësoni, merrni ato gur kishe e xhami ndërtoni, me hatër ose me zor nëse doni të jetoni, kur të bëheni muhamedan në tokat e juaja mund të jetoni dhe t'i punoni. Edhe ata pak katolikë romakë që kanë mbetur martirë do të shndërrohen ose do të bëjmë që të duken si të

krishterë të orientit të mjerë që zotin e tyre me 'allah' ta thirrin. Po ku janë ata shqiptarë që Shqipërisë i thanë Nanë. Këtë Nanë që Zoti e bani Teutë dhe Shotë Galicë në mes të Shqipërisë. Po sot qysh jetoni, ata që ju vranë me paret e juaja prapë qendisin minare për qyqet me këndu me vajtu se shqiptarët vendin dhe frontin e kanë leshu. O shqiptar sot ku jeni. A e dini këtë të mbron, bëhuni të gjallë. Kemi katër burra në Hagë, katër Apostuj që i dhanë lirinë dhe paqen Dardanisë, për me ba zotin e shtëpisë. Si i kapi këto pengje tradhtia, a mos valle prapë mbi shqiptar po gjykon Rusia, Serbia dhe Turqia...!", ka shkruar Bislimi në "Facebook".

## Tre të vdekur gjatë një aksidenti në liqenin e Badocit

PRISHTINË, 6 TETOR - Tre persona kanë humbur jetën, pasi vetura me të cilën po udhëtonin ra në liqenin e Badocit. Policia e Kosovës tha se aksidenti ndodhi në orët e vona të së shtunës në rrugën Gjilan-Prishtinë. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se pas marrjes së informacionit për këtë vetaksident, Policia e Kosovës ka intervenuar. Me ndihmën e Forcave të Sigurisë së Kosovës dhe ekipeve të zjarrfikësve, vetura së bashku me trupat e pajetë janë nxjerr nga liqeni i Badocit. "Aktualisht, ekspertët e fushës janë duke bërë

hetime për shkakun e aksidentit", tha Sveçla. Ai u bëri thirrje qytetarëve që të vozisin me kujdes, me qëllim që të shmangen aksidente të tilla. Kryeparlamenti Glauk Konjufca tha se është informuar që autoritetet përkatëse janë "angazhuar maksimalisht me rastin për ta zbardhur" atë. Ai po ashtu bëri thirrje për kujdes të shtuar në trafik, për shkak reshjeve të shiut, që sipas tij, shtojnë rreziqet gjatë qarkullimit me automjete. Edhe liderët e opozitës, Memli Krasniqi dhe Ramush Haradinaj kanë ngushëlluar familjet e tri viktimave.



## Limaj në Prizren: Fryma pozitive po na përcjell gjithandej

PRIZREN, 6 TETOR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka takuar anëtarë kësaj partie në Prizren. Ai së bashku me kryetarin e

degës Zafir Berisha dhe bashkëpunëtorë, bashkëbiseduan dhe u koordinuan për vazhdimin e aktivitetit dhe nevojën e Nismës karshi zhvillimeve

politike në vend. "Nga Prizreni morëm përkrahjen për qëndrimet tona politike, duke u zotuar se aktiviteti jonë në shërbim të vendit do të vazhdojë në çdo situatë.

Fryma pozitive po na përcjellë gjithandej dhe sukcesi i Nismës tashmë është i garantuar!", ka shkruar Limaj në "Facebook".



# Miratohet Udhëzimi për Standardizimin e QR Kodit që do të përdoret për pagesat në Kosovë

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 TETOR - Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore ka miratuar Udhëzimin për Standardizimin e QR Kodit, i cili do të përdoret për transaksionet e pagesave në Republikën e Kosovës.

Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat dhe kërkesat teknike për zhvillimin dhe funksionimin e strukturës së QR kodit në Republikën e Kosovës, që do të përdoret për pagesat e shitjet me pakicë dhe për pagesat e faturave. Ai synon të promovojë përdorimin më të gjerë të pajisjeve digjitale dhe telefonave të mençur për kryerjen e pagesave, duke siguruar ndërveprim të qëndrueshëm dhe të sigurt midis ofruesve të shërbimeve dhe konsumatorëve.

Adoptimi i këtij standardi është pjesë e aktiviteteve dhe veprimeve të ndërmarra në fushën e pagesave, në kuadër të strategjisë së BQK-së për ndërtimin e një tregu modern dhe gjithëpërfshirës

për pagesat me vlerë të vogël. Kjo përfshin edhe zhvillimin e kornizës ligjore dhe rregullative si dhe modernizimin e infrastrukturës, me qëllim sigurimin e një sistemi të sigurt, efikas dhe konkurrues për pagesat në vend.

BQK-ja ka adoptuar standardin e përcaktuar nga Këshilli Evropian për Pagesa (EPC), i cili përfshin standardin e QR kodit që përdoret në BE për transferet e pagesave të iniciuara nga telefonat e mençur dhe për sistemet e pagesave të shpejta. Ky standard pritet të përdoret gjithashtu nga vendet e rajonit në kuadër të projektit të BE-së për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave të Vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Përdorimi i këtij standardi do të sjellë disa përparësi dhe përfitime, si: Për qytetarët metodë e shpejtë dhe e përshtatshme për kryerjen e pagesave, duke skanuar QR kodet me pajisje digjitale. Kjo redukton gabimet në detajet e pagesës dhe përshpejton procesin, duke ndihmuar gjithashtu në



menaxhimin më të mirë të financave personale.

Për tregtarët dhe ofruesit e shërbimeve: ju mundëson ofrimin për klientët e tyre, një mënyrë të thjeshtë për të kryer pagesa përmes QR kodit standard, pavarësisht nga ofruesi i shërbimeve të pagesave. Kjo mundëson përpunimin automatik dhe të sigurt të pagesave, duke thjeshtuar gjithashtu proceset për barazimin e llogarive dhe çështjet

e pajtueshmërisë.

Për ofruesit e shërbimeve të pagesave: bankat dhe ofruesit tjerë të pagesave kanë mundësi të integrojnë lehtësisht këtë standard në aplikacionet e tyre, duke reduktuar pengesat teknike. Standardizimi lehtëson gjithashtu identifikimin e transaksioneve të dyshimta.

Për institucionet publike: digjitalizimi i shërbimeve dhe qartësia në lidhje me pagesat e

pranuara do të jenë përfitime të rëndësishme. Pagesat mund të kategorizohen sipas qëllimit të tyre (taksa, tarifa, gjoja, etj.), duke thjeshtuar procedurat për realizimin e pagesave në distancë përmes platformave si e-Kosova apo përmes telefonave mobil në pikat e shitjes.

Me këtë standard, Banka Qendrore synon që në Republikën e Kosovës, QR kodet të përdoren në mënyrë efikase për qëllime pagesash në sisteme dhe platforma të ndryshme, duke reduktuar fragmentimin e tyre. Për më tepër, adoptimi i standardit të QR kodit të Këshillit Evropian për Pagesa (EPC) synon të lehtësojë procesimin e pagesave jo vetëm brenda vendit, por edhe në nivel rajonal dhe në zonën SEPA, në përputhje me objektivat strategjike të BQK-së.

Zbatimi i këtij standardi tani varet nga zhvillimet teknike dhe infrastrukturale e nevojshme që ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuara në Kosovë do të vendosin në funksion.

## Rënie e dukshme e konsumit të energjisë elektrike në veri të Kosovës pas fillimit të faturimit



PRISHTINË, 6 TETOR - Kryeshefi ekzekutiv i Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT), Evetar Zeqiri, ka njoftuar për një ulje të ndjeshme në konsum të energjisë elektrike në katër komunat veriore të Kosovës gjatë tetë muajve të parë të vitit 2024, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sipas Zeqirit, ky krahasim është bërë pas fillimit të operimit të ndërmarrjes "Elektrosever" Sh.p.k., që nga 1 janari 2024, e cila ka marrë përsipër nominimin dhe faturimin e energjisë për konsumatorët në komunat veriore.

Ai theksoi se është vërejtur një rënie prej 35% të konsumit të energjisë elektrike në periudhën janar-gusht të vitit 2024, krahasuar me vitin paraprak. "Fillimi i faturimit të energjisë elektrike në

veri, masat e Qeverisë së Kosovës për luftimin e informalitetit, si dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për kursimin e energjisë mund të jenë faktorë kyç që kanë ndikuar në këtë rënie", tha Zeqiri.

Nga 1 janari 2024, në katër komunat në veri të Kosovës ka nisur regjistrimi dhe faturimi i energjisë elektrike, pas një marrëveshjeje komerciale të arritur mes Kompanisë për Distribucionin e Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) dhe Elektroserver.

Nënshkrimi i kësaj kontrate është konsideruar një hap drejt normalizimit të furnizimit dhe faturimit të energjisë në këtë rajon. Elektroserver është një ndërmarrje e kompanisë energjetike serbe, Elektroprivreda Srbije (EPS), e cila mori licencën për operim në Kosovë nga Zyra e Rregullatorit për Energji më 24 qershor 2024.

## AKK-ja kërkon ndryshime në Ligjin për tatimin në pronë: Faturat mund të rriten deri në 300 për qind

PRISHTINË, 6 TETOR - Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Sazan Ibrahim, ka shprehur shqetësimin mbi efektet e Ligjit të ri për tatimin në pronë, i miratuar vitin e kaluar, dhe rritjen e ndjeshme të faturave për pronat komerciale. Në një deklaratë për Telegrafin, Ibrahim theksoi se ky ligj do të ketë pasoja të rënda për bizneset, pasi rritja e normave tatimore mund të arrijë deri në 300%. "E kemi kalkuluar vlerën minimale të faturës së tatimit në pronë dhe diferenca mes vlerës së faturës së këtij viti dhe asaj të

vitet të ardhshëm është jashtëzakonisht e madhe", tha Ibrahim.

Ai theksoi se Kryetarët e Komunave dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës e kanë kundërshtuar këtë ligj për shkak të rritjes së konsiderueshme të faturave, e cila është bërë nga Ministria e Financave pa asnjë konsultim me komunat.

Ibrahim paralajmëroi se kjo rritje do të përballë bizneset me një barrë të madhe financiare, duke rrezikuar zhvillimin ekonomik të vendit. "Kjo do ketë pasoja në biznese sepse me

normën minimale të tatimit në pronë mund të ngritët më shumë se 200% apo të dyfishohen faturat për biznese dhe nëse kjo normë do jetë më e madhe, që e lejon ligji, atëherë faturat mund edhe të ngritën për 300% apo trefishohen por mund edhe të katërshifohen", theksoi ai. Asociacioni i Komunave të Kosovës kërkon nga niveli qendror që të fillojë me amendamentimin e këtij ligji në mënyrë që të diskutohet me komunat dhe të merret parasysh mirëqenia e qytetarëve të Republikës së Kosovës.



# Kaizeri, Cari dhe Mbreti George V: Kushërinjtë në luftë

Mbretëresha Viktoria kishte 42 nipër e mbesa të cilët ishin të shpërndarë në të gjithë Evropën dhe të ngulitur në shumë nga monarkitë e kontinentit. Kjo do të thoshte se Lufta e Parë Botërore në fund, ishte një çështje familjare



Siç e dinë shumë njerëz që kanë studiuar pemën e tyre familjare, sa më shumë të këqymri pemën tuaj familjare, aq më shumë surpriza ka të ngjarë të zbuloni. Mund të vini re lidhje befasuese midis degëve të largëta të pemës suaj dhe të mësoni mënyrat e papritura se si individët – ndoshta me prejardhje të ndryshme dhe që jetonin në vende të ndryshme – ndanin të njëjtën linjë gjaku.

Një shembull dramatik i kësaj që po themi, është Familja Mbretërore dhe plejada e çuditshme e lidhjeve pas Luftës së Parë Botërore. Britania mund të ishte përfshirë nga ethe të zjarrta kundër Gjermanisë, me Rudyard Kipling që paralajmëronte se 'Huni është te porta', por ajo që harrohet shpesh është se monarku britanik në atë kohë, George V, ishte kushëri i parë i Kaizerit Vilhelm i Gjermanisë. Që të dy ishin nipër të mbretëreshës Viktoria.

Babai i George V, Eduardi VII, ishte djali i madh i Viktorias. Ai

ishte bërë mbret pas vdekjes së nënës së tij në vitin 1901, duke sunduar vetëm për nëntë vjet derisa edhe vetë vdiq në vitin 1910, kur George V mori detyrën. Nëna e Xhorxhit, meqë ra fjala, ishte Alexandra e Danimarkës – një fakt domethënës të cilit do t'i rikthehem.

Kaizeri gjerman, ndërkohë, ishte nipi i mbretëreshës Viktoria nga vajza e saj, e quajtur gjithashtu Viktoria, e cila ishte martuar me Frederikun III të Gjermanisë. Në fakt, lidhjet e Vilhelmit me Familjen Mbretërore Britanike ishin shumë më tepër se një çështje gjenetike. Që fëmijë, ai ishte veshur me veshjet e malësisë për martesën e xhaxhait të tij Bertie (i njohur ndryshe si Eduard VII) me Aleksandrën e Danimarkës. Kur ishte adoleshent, atij iu dha Urdhëri i Garter-it nga Mbretëresha Viktoria, madje ai do të ishte i pranishëm edhe në shtratin e saj të vdekjes.

Shumë kronistë të kësaj periudhe janë magjepsur nga marrëdhënia

e vështirë e Vilhelmit me lidhjet e tij britanike, veçanërisht duke vënë në dukje armiqtë e tij ndaj xhaxhait Bertie – të cilin Vilhelmi e quante "pallua i vjetër" dhe madje "një Satana". Sipas fjalëve të historianit David Fromkin, "ana gjysmë gjermane e tij ishte në luftë me anën gjysmë angleze". Në të vërtetë, ambiciet militariste të Kaizerit në skenën evropiane mund të jenë nxitur pjesërisht nga ajo që Miranda Carter, autore e "Tre Perandorët: Tre kushërinjtë, Tre Perandoritë dhe Rruga drejt Luftës së Parë Botërore", e quan 'prekshmëria e tij adoleshente dhe dëshira pothuajse edipale për të mundur britanikët.

Aktori i tretë mbretëror në Luftën e Parë Botërore, Cari Nikolla II i Rusisë, kishte gjithashtu një interes shumë personal në ngjarjet. Ai ishte një tjetër kushëri i parë i George V, nëna e të cilit, Aleksandra e Danimarkës, ishte motra e nënës së Carit, Dagmar e Danimarkës. Përveçse ishin të lidhur ngushtë, Xhorxhi V dhe

Nikolla II ngjanin çuditërisht shumë dhe kishin krijuar një miqësi të fortë në vitet e tyre të rinisë. Lidhjet e Carit me mbretërit britanikë u forcuan më tej kur ai u martua me mbesën e preferuar të Mbretëreshës Viktoria, Princeshën Alik të Hesse (e cila do të vdiste së bashku me të dhe fëmijët, kur familja e Carit u masakrua nga revolucionarët komunistë në vitin 1918).

Sa i përket Vilhelmit dhe Nikollës – ata ishin gjithashtu të lidhur, duke qenë kushërinj të largët nëpër shtëpitë mbretërore ruse dhe prusiane. Ata komunikuan me telegrame dhe letra përpara Luftës së Parë Botërore, duke e quajtur njëri-tjetrin "Uilli" dhe "Niki" dhe dukeshin gjithnjë e më të shqetësuar për gjasat e konfliktit midis kombeve të tyre. "Që të shmangni një fatkeqësi të tillë siç është një luftë evropiane," i shkroi Cari Kaizerit në vitin 1914, "unë ju lutem në emër të miqësisë sonë të vjetër që të bëni ç'të mundeni për të ndaluar

aleatët tuaj të shkojnë shumë larg."

Sigurisht, konflikti shpërtheu. Pak më shumë se një vit pas dasmës së vajzës së Kaizerit, Princeshës Viktoria Louise të Prusisë – një rast i shkëlqyer në të cilin George, Nikolla dhe Vilhelmi ishin së bashku për herë të fundit – kushërinjtë ishin në luftë, me Britaninë dhe Rusinë aleate kundër Gjermanisë.

Masakra e paprecedentë e Luftës së Madhe – e mekanizuar, brutale – hodhi poshtë idenë se lidhjet e ngushta familjare midis familjeve mbretërore do të parandalonin kombet të shkonin në gjakderdhje. Mbretëresha Viktoria ishte konsideruar si

gryshja e Evropës dhe, siç shkruan historiani mbretëror, Theo Aronson, "vështirë se kishte një oborr kontinental që të mos mburrej me të paktën një nga marrëdhëniet e saj". Por asnjë nga këto nuk kishte vlerë, sepse aleancat e ndryshme të shteteve në fund do t'i dënonin të gjitha me luftë. / bota.al



# Java që shtyu Lindjen e Mesme në prag të luftës totale



Ka pasur shumë momente rreziku ekstrem gjatë vitit të kaluar. Ky është më i keqi.

Në shtatë ditët e fundit, lideri i Hezbollahut, Hassan Nasrallah është vrarë, Izraeli ka nisur një pushtim tokësor të Libanit dhe Irani ka goditur me rreth 200 raketa balistike në objektivat anembanë Izraelit.

Fuqitë perëndimore dhe rajonale – të udhëhequra nga SHBA – kanë kërkuar uljen e tensioneve. Këshilli i Sigurimit i OKB-së bëri thirrje për “përfundim të menjëhershëm” të luftimeve dhe G7, që përfshin SHBA-në,

Britaninë e Madhe dhe Gjermaninë, ka bërë thirrje për “përmbytje”.

Por deri më tani këto përpjekje kanë dështuar – dhe Lindja e Mesme është më afër se kurrë një lufte gjithëpërfshirëse.

Kjo ishte java që afrooi luftën totale, dhe ja çfarë ndodhi:

## Mbrëmja e së premtes: Vritet Nasrallah

Ndërsa dielli perëndonte mbi Bejrut më 27 shtator, jugu i qytetit u sulmua dhe u dëgjuan një seri shpërthimesh të forta.

Disa ndërtesa banimi u goditën, duke lënë një krater të madh në tokë. Kolonat e pluhurit dhe mbeturinave mbushën horizontin, të dukshme nga i gjithë kryeqyteti libanez.

Sulmi, që kishte në shënjestër një bunker nëntokësor, vrau liderin e Hezbollahut, Hassan Nasrallah. Nasrallah nuk ishte parë në publik për vite me radhë nga frika se mos vritej nga Izraeli.

Vdekja e tij mbylli një javë sulmesh të përshkallëzuara izraelite që kishin në shënjestër Hezbollahun dhe kishin lënë pas, më shumë se 500 të vdekur.

Një javë më parë, një seri shpërthimesh radiosho dhe pagerash, lanë të paktën 32 të vdekur dhe mbi 3000 të plagosur. Vdekja e Nasrallahut fshiu të gjitha shpresat e një uljeje të tensioneve, që vetëm disa orë më herët dukej si diçka e mundur.

Një propozim i SHBA për një armëpushim 21-ditor ishte diskutuar në skajet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB) në Nju Jork. Ambasadori i Izraelit në OKB, Danny Danon, madje kishte thënë se pala e tij ishte “e hapur ndaj ideve”.

Por disa orë pas sulmit, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ndodhej në një fluturim të nxitur për në shtëpi nga OKB – dhe çdo shpresë për mbizotërimin e diplomacisë u shua.

## Mbrëmja e së hënës: Izraeli pushton Libanin

Tre ditë më vonë, forcat izraelite hynë në Liban, duke shënuar fillimin e një pushtimi tokësor.

Forcat e Mbrojtjes të Izraelit (IDF) thanë se operacionet e tyre do të jenë “të kufizuara dhe të shënjestruara”.

Luftimet e deritanishme kanë dëbuar afro 1.2 milionë njerëz nga shtëpitë e tyre, sipas njësisë së krizave të Libanit. Të paktën 8 ushtarë izraelitë janë vrarë.

Izraeli thotë se operacioni ka për qëllim ndalimin e aftësisë së

Hezbollahut për të lëshuar raketa dhe dronë përtej kufirit – diçka që grupi terrorist e ka bërë pothuajse çdo ditë që kur Hamasi, aleati i tij palestinez, kreu një sulm vdekjeprurës në Izraelin jugor pothuajse një vit më parë, duke nxitur Luftën e Gazës.

Tani trupat izraelite po bëjnë një luftë tokësore në dy fronte njëkohësisht: Gaza dhe Liban. Kjo nuk ka ndodhur në disa dekada.

Lufta e fundit midis Izraelit dhe Hezbollahut, në vitin 2006, përfundoi me Rezolutën 1701 të OKB-së, e cila përcaktonte se Hezbollahu duhej të tërhiqte forcat nga Libani jugor.

Kjo nuk ndodhi kurrë dhe me mbështetjen iraniane, Hezbollahu u rrit në fuqi.

Izraeli nuk ka thënë se dëshiron të eliminojë tërësisht Hezbollahun nga peizazhi politik i Libanit (siç ka bërë me Hamasin në Gaza), por me gjithë fjalët se ky është një operacion “i kufizuar dhe i targetuar”, është e qartë se Izraeli është i vendosur të dobësojë pa mëshirë Hezbollahun.

## Mbrëmja e së martës: Irani sulmon Izraelin

Të nesërmen, rreth orës 19:30 me orën lokale, 10 milionë izraelitë u njoftuan të vraponin drejt vendstrehimeve në të gjithë vendin, pasi Irani lëshoi rreth 200 raketa balistike ndaj Izraelit. Sistemi i mbrojtjes ajrore hyri shpejt në veprim – dhe aleatët përfshirë SHBA-në dhe Britaninë e Madhe u përfshinë në

zmbropsjen e sulmit – një tjetër shenjë e zgjerimit të konfliktit.

